



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ prot.

Elbasan, më ____ . ____ .2022

LËNDA: Dërgim njoftimi për botim në Buletinin e Prokurimit Publik.

AGJENCISË së PROKURIMIT PUBLIK

TIRANË

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR**

(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Drejtuar: **“Flamur Asllani” p.f.** me adresë: Lagjja "Dyli Haxhire", bulevardi "Aqif Pasha", pall. nr. 10/1, kati 1, Elbasan.

* * *

Procedura e prokurimit: Procedurë e Hapur mbi kurfirin e larte monetar - Marreveshje Kuader.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës ;**Loti I: “Blerje produkte ushqimore - Marrëveshje Kuadër - me disa operatorë ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 15 muaj, me fond limit 22,197,100 (njëzet e dymilion e njëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëqind) lekë (pa tvsh) dhe me shumatoren e cmimeve per njesi prej 8,909 (tetë mijë e nëntëqind e nëntë) lekë pa t.v.sh., vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2022 dhe 2023. Ky fond përbën vlerën e pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër.**

Numri i referencës së procedurës/lotit: Loti I: REF-42498-09-20-2022

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të kësaj bëjmë me dije se në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. “FLAMUR ASLLANI” p.f. me Nipt: L 62602209 S

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar është **7’609** (shtatë mijë e gjashtëqind e nente) **lekë** (pa tvsh).

2. “NELSA” sh.p.k me Nipt: J 71601012 S

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar është **6’783** (gjashtë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e tre) **lekë** (pa tvsh).

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

1. “NELSA” sh.p.k me Nipt: J 71601012 S s’kualifikohet për arsyet e mëposhtme:

1. Në pikën 2.3.4 , të shtojcës 7, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarde të tenderit, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qira ambjent të përshtatshëm me sipërfaqe minimumi 50 m2 për prodhimin ose magazinimin e mallrave që janë objekt i këtij prokurimi, për të cilin duhet të paraqesë **aktin e pronësisë ose kontratën e marrjes me qira të objektit**, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së objektit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë të jetë noteriale dhe të jetë e vlefshme për gjithë periudhën e zbatimit të kontratës. Ambjenti duhet të plotësojë kushtet higjieno sanitare dhe teniko teknologjike, vërtetuar kjo nga organet kompetente në zbatim të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” si dhe ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar.

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një deklaratë për disponimin dhe adresën e saktë të ambjentit. **Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të ambjentit.**

1. Në pikën 2.3.8 , të shtojcës 7, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarde të tenderit, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit i realizuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), operatori ekonomik ka rezultuar se ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Nelsa” SHPK rezulton se është paraqitur, në përmbushje të kriterëve të sipërcituara:

1.Deklarate hedhur ne SPE “Deklaratë Ambjentesh” datë 21.10.2022 ku citohet: “adresë në Lagjja Qesarak, Rruga Tirane-Dajt, Zona kadastrale 2460, me Nr.pasurie 199/32, Hyrja 1, Dajt-Tiranë, deklaroj se per mallrat objekt prokurimi (produkte ushqimore) disponojme ambientet perkatese ne adresen: “Lagjja Qesarak, Rruga Tirane-Dajt, Zona kadastrale 2460, me Nr.pasurie 199/32-G1”, me nje siperfaqe totale 234 m² (çertifikatë pronësie 1236423), nga të cilat 60 m2 për magazinimin e produkteve ushqimore.

2. Deklaratë 21.10.2022 ku citohet: Unë, Znj. Elsa Kamberi përfaqësuese e shoqërisë “NELSA” Shpk, regjistruar në regjistrin tregëtar më datë 23/02/1996 me Nr. NUIS, J71601012S me adresë në Lagjja Qesarak, Rruga Tirane-Dajt, Zona kadastrale 2460, me Nr.pasurie 199/32, Hyrja 1, Dajt- Tiranë, *deklaroj se nga kontrolli i fundit i realizuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), ka rezultuar se shoqëria jone ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.*

3.Kontratë Huapërdorje Nr. rep 41 dhe Nr. kol 17 nënshkruar në datë 11.01.2021 me palë huamarrëse Shoqëria “Nelsa” SHPK dhe huadhënëse N.B ku objekt i kësaj kontrate është marrja në përdorime pasurive të paluajtshme si mëposhtë :

1. GARAZH, i ndodhur në Dajt zona kadastrale 2460, volumi 45, faqe 167, me sipërfaqe 234 m2, vërtetuar kjo sipas çertifikatës për vërtetim pronësie lëshuar nga Z.V.R.P.P. Tiranë.

2.Njësi e ndodhur në Dajt zona kadastrale 2460, volumi 45, faqe 170, me sipërfaqe 208 m2, vërtetuar kjo sipas çertifikatës për vërtetim pronësie lëshuar nga Z.V.R.P.P. Tiranë.

3. Njësi e ndodhur në Dajt zona kadastrale 2460, volumi 45, faqe 171, me sipërfaqe 103 m2, vërtetuar kjo sipas çertifikatës për vërtetim pronësie lëshuar nga Z.V.R.P.P. Tiranë.

4. Proces verbal inspektimi Nr. AKU-TR-2022-001594-2 datë 01.03.2022 lëshuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit mbi ushtrimin e aktivitetit të ruajtjes, magazinimit dhe shpërndarjes me pakicë e shumicë të produkteve ushqimore si dhe të fruta perimeve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm KVO konstatoi se OE ka paraqitur për të vërtetuar disponueshmërinë e ambientit një kontratë huapërdorje, çka bie në kundërshtim me përcaktimet e kriterit 2.3.4 ku forma ligjore e kërkuar për disponimin e ambientit është pronësia ose qiraja.

Gjithashtu nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se OE ka deklaruar si vendndodhje të ambientit adresën: “Lagjja Qesarak, Rruga Tiranë-Dajt, Zona kadastrale 2460, me Nr.pasurie 199/32-G1”, me një sipërfaqe totale 234 m² (çertifikatë pronësie 1236423), nga të cilat 60 m² për magazinimin e produkteve ushqimore. Gjithashtu, operatori ekonomik, duhet të vërtetojë se këto ambiente magazinimi plotësojnë kushtet higjeno-sanitare të përcaktuara nga legjislacioni sektorial në fuqi, për të cilat OE ka paraqitur proces verbal inspektimi Nr. AKU-TR-2022-001594-2 datë 01.03.2022 lëshuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit mbi ushtrimin e aktivitetit të ruajtjes, magazinimit dhe shpërndarjes me pakicë e shumicë të produkteve ushqimore si dhe të fruta perimeve. Ky proces verbal konstatimi i referohet inspektimit të ushtruar në ambientet e OE "Nelsa" Shpk me adresë: *Lagjja Qesarak, Rruga Tirane-Dajt, Zona kadastrale 2460, me Nr.pasurie 199/32, Hyrja 1,Dajt,TIRANE,Tirane*), çka përkon edhe me adresën e deklaruar nga OE si vendi i ushtrimit të kontrollit të fundit të ushtruar nga AKU-ja. Kjo adresë e përcaktuar si vendi i ushtrimit të inspektimit nga AKU-ja në procesverbalin e mbajtur apo në deklarimin e OE është e përgjithshme pasi nga verifikimi i pasi referuar dokumentacionit të administruar në SPE, me të njëjtin numër pasurie ekzistojnë tre pasuri të vecanta, me sipërfaqe të ndryshme me certifikata pronësie të vecanta, me numër volume dhe faqe, me nr. pasurie të ndryshme pra me specifikimet e vecanta që këto certifikata përmbajnë. Referuar objektit të procedurës së prokurimit, objekti i kësaj të fundit, referuar loteve në të cilën ka marrë pjesë edhe operatori ekonomik ankimues, mallrat objekt prokurimi, janë karakteristikave të ndryshme si produkte ushqimore, fruta perime dhe produkte bulmeti, mallra të cilat kërkojnë kushte të posacme për magazimin ruajtjen e tyre. Në këto kushte është detyrë e operatorit ekonomik që të vërtetojë se disponon mjediset e përshtatshme për ruajtjen dhe magazinimin e mallrave objekt prokurimi dhe fakti i vetëm se ky i fundit disponon një sipërfaqe më të madhe se a jo e kërkuar nuk është një kusht për kualifikimin e tij, pasi nga analizimi i kriterit në tërësi, për autoritetin kontraktor është kërkuar që për secilën magazinë të shoqërohet me lejen higjeno sanitare.

Ndërkohë referuar proces verbalit të inspektimit Nr. AKU-TR-2022-001594-2 datë 01.03.2022 lëshuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit si dhe deklarimit të OE mbi kontrollin e fundit të ushtruar nga AKU-ja nuk mund të merret informacion i kërkuar në lidhje me faktin se cilat prej sipërfaqeve të deklaruara me anë të tre akteve të ndryshme të pronësisë janë të vlerësuar me leje higjeno sanitare përkatëse nëpërmjet proces verbalit të

inspektimit Nr. AKU-TR-2022-001594-2 datë 01.03.2022 lëshuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit si dhe deklarimit të OE mbi kontrollin e fundit të ushtruar nga AKU-ja, pra ndarja e ambienteve të magazinimit nuk është e evidentueshme nëpërmjet akt-miratimeve higjenosanitare duke mos dhënë asnjë informacion mbi cilën prej vendodhjeve, pasurive individuale referuar certifikave të dorëzuar në SPE janë bërë edhe vlerësimet higjeno-sanitare.

Ky është edhe qëndrimi që ka mbajtur Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr.711/2021 datë 04.10.2021, ku ndër të tjera thekson si mëposhtë:

Referuar objektit të procedurës së prokurimit, KPP sqaron se objekti i kësaj të fundit, referuar loteve në të cilën ka marrë pjesë edhe operatori ekonomik ankimues, mallrat objekt prokurimi, janë karakteristikave të ndryshme si produkte ushqimore, fruta perime, mish dhe produkte bulmeti, mallra të cilat kërkojnë kushte të posacme për magazimin ruajtjen e tyre. Në këto kushte është detyrë e operatorit ekonomik që të vërtetojë se disponon mjediset e përshtatshme për ruajtjen dhe magazinimin e mallrave objekt prokurimi dhe fakti i vetëm se ky i fundit disponon një sipërfaqe më të madhe se a jo e kërkuar nuk është një kusht sine qua non për kualifikimin e tij, pasi nga analizimi i kriterit në tërësi, për autoritetin kontraktor është kërkuar që për secilën magazinë të shoqërohet me lejen higjeno sanitare. Ndërkohë, referuar akteve, lejeve higjeno sanitare të dorëzuar, sërish nuk mund të merret informacion i kërkuar në lidhje me faktin se cilat prej sipërfaqeve të deklaruara me anë të tre akteve të ndryshme të pronësisë janë të vlerësuar me leje higjeno sanitare përkatëse. KPP gjykon se, ndarja e ambienteve të magazinimit nuk është e evidentueshme nëpërmjet akt-miratimeve higjenosanitare. Komisioni risjell në vëmendje se është barrë e operatorëve ekonomikë ankimues që të provojnë se disponojnë kapacitetet e duhura për të zbatuar me sukses dhe cilësinë e kërkuar kontratën objekt prokurimi dhe në rastet kur me anë të dokumentacionit të paraqitur këta të fundit nuk arrijnë të provojnë disponimin e kapaciteteve të kërkuara, ofertat e tyre duhet të refuzohen si të papranueshme.

Nga verifikimi i ekstraktit të QKB-së, konstatohet se ambjenti i deklaruar nga OE me Nr.pasurie 199/32-G1, Zona kadastrale 2460, Lagjja Qesarak, Rruga Tirane-Dajt, nuk figuron i regjistruar si vend ushtrimi aktiviteti në QKB, duke mos përmbushur kriterin e përcaktuar në gërmën a) të shtojcës 7, “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit” ku parashikohet shprehimisht :

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Në nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për qendrën kombëtare të biznesit", i ndryshuar, ndër të tjera parashikohet:

3. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, subjekti duhet të regjistrojë dhe të depozitojë aktet përkatëse, si më poshtë:

d) vendet e tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia.

Operatori ekonomik s'kualifikohet per arsyet e mesiperme.

Në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

1. "Flamur Asllani" p.f. me adresë: Lagjja "Dyli Haxhire", bulevardi "Aqif Pasha", pall. nr. 10/1, kati 1, Elbasan, se oferta e paraqitur, me shumatoren e çmimeve për njësi prej **7'609** (shtatë mijë e gjashtëqind e nëntë) **lekë** (pa tvsh), është identifikuar si fitues (paraparak) të procedurës së prokurimit.

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqiteni tek Autoriteti Kontraktor, **Bashkia Elbasan** adresa: rruga "Qemal Stafa", Elbasan brenda 5 (pese) ditëve nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO JO x

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO x

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ
ZV.KRYETARI
Aulona Bylykbashi**